

Të shtunën, nga një njeri i panjohur, u vra zëvendësmufti i Osetisë Veriore (një nga republikat e Federatës Ruse), Rasul Gamzatov në kryeqytetin Vladikavkaz.

"Zëvendësmufti u qëllua në kokë nga mbrapa derisa ishte duke dalë nga vetura e tij" citon agjencia ruse e lajmeve Interfax.

Lajmin për Interfax-in e ka konfirmuar Ministria e Brendshme e këtij shteti dhe ka thënë se hetimet janë duke vazhduar.

[Në dhjetor të vitit 2012 ishte vrarë edhe një klerik i këtij vendi, Ibrahim Dudarov](#), i cili po ashtu ishte zëvendësmufti, duke u qëlluar me pesë plumba nga një distancë e afërt. Vrasësit e tij ende nuk janë gjetur./Shembulli/

